

URDHËR
Nr. 433, datë 6.7.2018

**PËR RIPËRTËRITJEN E LICENCËS AGJENCISË FMAA NË ADMINISTRIMIN
KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TË AUTORËVE NË FUSHËN E
KINEMATOGRAFISË
DHE TË VEPRAVE TË TJERA AUDIOVIZUALE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 134, 135, 157 dhe 158, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; të udhëzimit nr. 5166, datë 20.10.2016, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të tjera shitesë në sqarim të kriterëve të parashikuara në nenin 133, si dhe përcaktimin e kushteve dhe procedurës së marrjes së licencës ose ripërtëritjen e saj”, në bazë të nenit 134, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; si dhe kërkesës së agjencisë FMAA për ripërtëritje të licencës nr. 3116 prot., datë 7.5.2018; të urdhrit të ministrit të Kulturës nr. 205, datë 4.4.2018, “Për ngritjen e grupit të punës, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për licencim/ripërtëritjen e tyre në fushat e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në administrimin kolektiv, në përputhje me kriteret dhe procedurat e parashikuara në ligjin 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to””, ndryshuar me urdhrin nr. 228, datë 17.4.2018, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 205, datë 4.4.2018”, si dhe legjislacionin në fuqi “Për organizatat jofitimprurëse”,

URDHËROJ:

1. Ripërtëritjen e licencës së agjencisë FMAA si agjenci e administrimit kolektiv të të drejtave të autorëve në fushën e kinematografisë dhe të veprave të tjera audiovizuale.
 2. Afati i licencës është tre (3) vjet nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.
 3. Pas botimit në Fletoren Zyrtare të urdhrit të ministrit të Kulturës për ripërtëritjen e licencës, agjencia është e detyruar të kryejë pagesën në vlerën prej 300.000 lekësh, e parashikuar në vendimin nr. 33, datë 18.1.2017, “Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit”.
 4. Ngarkohet Drejtoria e së Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I KULTURËS
Mirela Kumbaro Furxhi